

VENDIM
Nr.54, datë 26.1.2011

**PËR PJESËMARRJEN NË STËRVITJE TË DY KOMPANIVE TË FORCAVE TOKËSORE
TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË QENDRËN
E BASHKUAR NDËRKOMBËTARE TË GATISHMËRISË (JMRC), NË HOHENFELS, GJERMANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e dy kompanive të Forcave Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me personel 200 (dyqind) ushtarakë, në stërvitjen e përbashkët, në Qendrën e Bashkuar Ndërkombëtare të Gatishmërisë (JMRC) në Hohenfels, Gjermani.

2. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është trajnimi i trupave para dërgimit me mision në Afganistan.

3. Kohëzgjatja e stërvitjes është nga data 7-23 shkurt 2011.

4. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha